

VENDIM
Nr. 67, datë 29.1.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 531, DATË 7.9.2023, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE SHTETËRORE
‘OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA’ SHA, PËR KRYERJEN E
PROCEDURAVE TË VEÇANTA TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR
LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË
VARËSISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 105, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 15, e vendimit nr. 531, datë 7.9.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore ‘Operatori i Blerjeve të Përqendruara’ sh.a., për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë”, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“15. Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. ka përgjegjësi të organizojë punën për kryerjen e procedurave të prokurimit, për të nënshkruar marrëveshjen kuadër, për të zhvilluar procedurën e konkurrimit ndërmjet operatorëve ekonomikë, palë në një marrëveshje kuadër, si dhe kryerjen e procedurave të prokurimit deri në lidhjen e kontratës.”.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a., dhe institucionet shtetërore/entet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku